



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2021:067816  
Datë: 22.06.2021  
Numri i dokumentit: 01911035

**PPP.nr.13/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbartimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit H. P. SH.P.K me nr te biznesit .., me adresë në Magj. Ferizaj Prishtinë, Talinoc i Muhaxherëve Komuna Ferizaj, përfaqësuar nga E. A. , kundër debitorit Komuna e Istogut Rr. Fadil Ferati Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 588.76 €, pas prapësimit te ushtruar nga ana e debitori, me dt: 17.03.2021 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, gjykata jashtë seance me dt.22.06.2021 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** prapësimi i debitorit Komuna e Istogut Rr. Fadil Ferati Istog, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.298/2021 të dt. 04.03.2021, **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.298/2021 të dt. 04.03.2021, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbartimore abrogohen.

**A r s y e t i m**

Kreditori, H. P. SH.P.K me nr. te biznesit .., me adresë në Magj. Ferizaj Prishtinë, Talinoc i Muhaxherëve Komuna Ferizaj, përfaqësuar nga E. A. ka ushtruar propozim për përmbartim ne bazë te dokumentit te besueshëm faturës, ndaj debitorit Komuna e Istogut Rr. Fadil Ferati Istog, duke kërkuar qe të lejohet përmbartimi dhe te obligohet debitori pagesën e borxhit ne shumë prej 588.76 €, me kamat ligjore prej 8 % nga dita kur borxhi është bërë i arritshëm e deri ne pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore te gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit te propozimit, në të kundërtën ti bllokoj të gjitha llogarit bankare te debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të bëhet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te pa luajtshme dhe mjetet e mbledhura të barten në llogari të

përmbaruesit privat, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim te datës 04.03.2021.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr.298/2021 të dt. 04.03.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit te kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, Komuna e Istogut Rr. Fadil Ferati Istog brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrit përmbarimor, duke i propozuar gjykatës që te nijetin urdhër ta hedhë si te pa rregullt ose te njëjtin ta refuzoj si te pa bazuar, me arsyetimin se propozimit i janë bashkangjitur faturat ne kopje te vërtetuara, e jo siç kërkohet me nenin 37 te LPP-së, po ashtu faturat nuk i përmbajnë elementet e kërkuara me nenin 38 par.2 te LPP-së. Me tutje debitori shton se edhe sikur faturat te ishin te rregullta përmbarimi nuk do te mund te behej për faktin se duke u bazuar ne nenin 353 te LMD-së ka ardhur deri tek parashkrimi- shuarja e te drejtës së kërkimit për përmbushjen e detyrimit.

Pas ngritjes se prapësimit nga debitori, kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me propozim që te refuzohet ne tersi prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor me arsyetimin se kreditori duke u mbështetur ne dispozitat e LPP-së ka iniciuar procedurën përmbarimore në bazë të dokumentimeve te besueshme- faturave, të cilat fatura janë kopje e vërtetuar tek noteri dhe janë të pranuar nga ana e debitorit. Me tutje kreditori shton se debitori nuk është e regjistruar si biznes, andaj vetëm bizneset kanë numër unik identifikues, ashtu që pretendimet e debitorit janë të pa bazuara dhe nuk ka ofruar asnjë provë, e duke vepruar në kundërshtim me nenin 69 te LPP-së.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit te provave tjera ne shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve te debitorit ne prapësimin e parashtruar lidhur me atë se propozimit i janë bashkangjitur faturat ne kopje te vërtetuara, e jo siç kërkohet me nenin 37 te LPP-së, po ashtu faturat nuk i përmbajnë elementet e kërkuara me nenin 38 par.2 te LPP-së, pretendimet e lartcekura i refuzoj si te pa bazuara pasi që faturat me te cilat është lejuara përmbarimi, janë në kopje porte vërtetuar konform nenit 37 te LPP-së, po ashtu te njëjtat fatura i përmbajnë te gjitha elementet siç kërkohen me nenin 29 par.1.3 dhe par.3 e ne lidhje me nenin 38 par.1 dhe 2 te LPP-së.

Kurse sa i përket pretendimeve të debitorit se kemi parashkrim të kërkesës së kreditorit konform dispozitave të LMD-së, të njëjtat pretendime gjykata i aprovoj si të bazuara duke u bazuar në nenin 355 të LMD-së ku par.1 i po të njëjtit nën parasheh se “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”, kurse par. 2 i po të njëjtit nën parasheh se “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”, e në rastin konkret kreditori në propozimin për përmbarim e kërkon borxhin për faturat Janar, Prill, Qershor, Shtator dhe Tetor të viti 2017, kurse propozimin për përmbarim e ka parashtruar me dt. 04.03.2021, çka kemi edhe parashkrim sepse kemi kalim të afatit 3 vjeçar ashtu siç parashihet me nenin e cekur më lartë, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin e debitorit, e rrjedhimisht edhe duke e shfuqizuar urdhrin përmbarimor.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.3 dhe par.3, 37, 38, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në lidhje me nenin 355 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.13/2021, dt.22.06.2021**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.